



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS FRËNGE**



**PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Përkthim Letrar B-A**

Ngarkesa: kredite : 30orë; leksione:10/seminare: 20

Viti akademik / semestri kur zhvillohet: Viti iII/Semestri:I

Lloji i lëndës: Lëndë me detyrim

Programi i studimit: Master në Përkthim teknik, letrar dhe Interpretim

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJET DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektiva të përgjithshme lëndore:

Lënda synon: Të transmetojë strategjitë e përkthimit letrar, sfidat e këtij përkthimi sot; Të zhvillojë aftësinë e analizës dhe të kuptuarit të nuancave kulturore, stilistikore dhe tematike të veprave letrare, si dhe përcjelljen e tyre në gjuhën mbërritëse; Të trajtojë qasjet e ndryshme teorike të përkthimit që zbatohen në rastin e teksteve letrare.

Objektiva specifike lëndore:

Studentiduhettënjojë se si të:

- Analizojë dhe të gjejë strategjitë e përkthimit të një teksti letrar;
- Rishprehë në gjuhën mbërritëse stilin e autorit, duke vlerësuar tonin e tekstit dhe figurat stilistikore ;
- Trajtojë referencat kulturore që të jenë sa më të kuptueshme në gjuhën mbërritëse.

Rezultate të pritshme:

- Aftësia për të mobilizuar kompetencat gjuhësore dhe letrare në të dyja gjuhët e punës;
- Aftësia për të pasuruar njohuritë kulturore në të dyja gjuhët;
- Aftësia për të njohur dhe vënë në zbatim teoritë e përkthimit;
- Aftësia për të pasur një qëndrim kritik gjatë analizës përkthimore;
- Aftësia për të zbatuar përkthimin letrar duke marrë në konsideratë elementet teorike të trajtuara në këtë rast.